R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
BASHKIA LUSHNJE

SHPALLJE PËR EKSPERT

Thirrje për ekspert për hartëzimin social të moshës së tretë në Bashkinë Lushnje

Projekti: "Një Kafe me Gjyshin"

Zona e projektit: Bashkia Lushnje

Kohëzgjatja e projektit: 31 Dhjetor 2024

Lloji i kontratës: Kontratë Shërbimi

Data e fillimit të punës: 7 Tetor 2024

Bashkia Lushnje kërkon të kontraktojë një ekspert për hartimin e metodologjisë së hartëzimit social të moshës së tretë në Bashkinë Lushnje si pjesë e projektit "Një Kafe me Gjyshin"zbatuar nga Bashkia Lushnje me mbështetjen e Fondit Social, MSHMS.

Rreth Bashkisë Lushnje

Bashkia e Lushnjes, pjesë e Qarkut të Fierit, është e përbërë nga 10 njësi administrative: Allkaj, Bubullimë, Ballagat, Dushk, Golem, Fiershegan, Kolonjë, Krutje, Karbunarë, Hysgjokaj, si dhe pesë rajone me 10 lagje për Lushnjen.

Bashkia Lushnje ka zhvilluar Politikat Sociale për territorin ku vepron të cilat përfshijnë: Mbulimin sa më të plotë i territorit me Shërbime Sociale duke u harmonizuar me nevojat dhe interesat e komunitetit. Gjithëpërfshirjen, pjesëmarrjen, krijimin e Mundësive të Barabarta dhe Mosdiskriminimin për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, origjinës, minoritetit etj. Bashkërendimin dhe harmonizimin e aktiviteteve lokale me strategjitë dhe politikat kombëtare, me instiucionet në varësi të pushtetit qëndror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare. Partneritetin e ngushtë ligjor me shoqërinë civile, organizata jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti.

Plani Social Vendor 2022 – 2025 i bashkisë Lushnjë u miratua me vendim të Këshillit Bashkiak Lushnje Nr. 18, datë 28/02/2023. Disa nga çështjet e përfshira në Planin Social Vendor: funksionet e bashkive për shërbimet sociale, politikat sociale vendore të bashkisë Lushnjë, shërbimet ekzistuese për mbrojtjen e fëmijëve në bashkinë Lushnje, analiza e aktorëve të përfshirë në ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, varfëria ekonomike dhe mbrojtja sociale, arsimi dhe formimi professional, punësimi dhe aftësitë, pjesëmarrja sociale dhe të drejtat e njeriut, shëndëtësia, objektivat e Drejtorisë së Shërbimit Social në bashkinë Lushnje, të dhëna mbi organizimin dhe kapacitetet e stafit të Bashkisë, Strategjia e zbatimit të planit social, Plani i veprimit të përfshirjes sociale, Strategjia e komunikimit të PVPS.

Rreth projektit

Kjo nismë zbatohet në kuadër të projektit "Një Kafe me Gjyshin"" me mbështetjene Fondit Social MSHMS.

Një nga objektivat strategjik në Planin Social Vendor 2022-2025 të bashkisë Lushnjë është integrimi dhe barazia në shërbime sociale, si dhe aksesin moshës së tretë në këto shërbime. Më konkretisht në plan citohet "Mbulimi më i mirë në terren për rastet që trajtohen, përfshirë vizitat në shtëpi. Siç raportohet nga Drejtoria e Shërbimit Social në bashkinë Lushnjë, ka një mungesë të dhënash statistikore dhe identifikuese për moshën e tretë nga ku dhe lind nevoja për kryerjen e hartëzimit social dhe ngritjen e një databaze me të dhëna për tu përditësuar vit pas viti. Gjithashtu, gjatë aktiviteteve dhe takimeve në komunitet, është identifikuar nevoja për rritjen e aktiviteteve sociale dhe argëtuese për moshën e tretë si dhe nevoja për shërbim në familje për të moshuarit e vetmuar.

Projekti ka si qëllim ngritjen e një shërbimi të ri për moshën e tretë në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetesës, nxitjes së pjesëmarrjes aktive dhe ndërveprimit në komunitet midis brezash. Për të arritur këtë qëllim projekti do të fokusohet në hartëzimin social me të dhëna mbi moshën e tretë; promovimit të aktiviteteve sociale të moshës së tretë dhe pjesëmarrjes së tyre aktive në komunitet, nxitjes së vullnetarizmit dhe bashkëveprimit midis brezave.

Struktura Përgjegjëse për Shërbimet Shoqërore në bashkëpunim me ekspertin në kuadër të këtij projekti do të realizojë edhe hartëzimin social të moshës së tretë në Bashkinë Lushnje.

Eksperti duhet të dorëzojë:

a) Metodologjinë e hartuar të hartëzimit social të moshës së tretë në Bashkinë Lushnje;

b) Formatet e hartuara për hartëzimin social të moshës së tretë;

Afatet kohore

Aktivitete	**Afati**
Dorëzim i draftit të parë të metodologjisë së hartëzimit social	30 Tetor
Dorëzimi i metodologjisë finale	31 Dhjetor

Kualifikime dhe eksperienca e punës:

- Diplomë universitare e ndërthurur me trajnime të specializuara në fushën e shkencave sociale;
- Njohuri shumë të mira rreth situatës së grupeve vulnerabël dhe në nevojë;
- Njohuri shumë të mira të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030;
- Njohuri shumë të mira të paketës ligjore të shërbimeve shoqërore;
- Më tepër se 5 vite eksperiencë profesionale si ekspert dhe praktikë në sistemin e mbrojtjes sociale, shërbimeve sociale;
- Trajnime dhe eksperienca të mëparshme në vlerësimin e nevojave të komunitetit ne nivel lokal dhe kombëtar;
- Përvojë me koordinimin e veprimeve për realizimin e raporteve dhe analizave në fushën e mbrojtjes sociale.
- Aftësi të mira në përdorimin e paketës MS Office

Kohëzgjatja e kontratës së shërbimit është deri 31 Dhjetor 2024 data e mundshme e fillimit të punës është 7 Tetor 2024.

Procedura e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e ekspertit duhet të dërgojnë me email:

1- Kërkese për Shprehje interesi,
2- Curriculum Vitae (CV)
3- Diplomë në nivelin Master Shknecor,Dega" Pune Sociale"(noterizuar)
4- Fotokopje Karte ID
5- Dëshmi Penaliteti
6- Certifikata/eksperienca të mëparshme

Gjithë dokumentacioni i aplikimit duhet të dorëzohet në adresën zyrtare të Bashkisë Lushnje deri në datën 30 Shtator 2024 me emertim: Aplikimi për "Ekspert për për hartëzimin social të moshës së tretë në Bashkinë Lushnje"

BASHKIA LUSHNJE